



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

UNIVERSITETI I PRISHTINËS - PASAN PRISHTINË
FAKULTETI I EDUKIMIT
PRISHTINË

Nr. Prot: _____

Date: _____

Pravler Nr.	Nr. Ora	Numer	Shifra	Vlera
	04	1608	-	-

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)

Fakulteti:

Fakulteti i Edukimit - Universiteti i Prishtinës

Pozita e shpallur në thirrje:

Pozita Nr. 5

Lëndët:

Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA – EFH) dhe
Metodika e edukimit fizik (BA – Fillor)

Kandidatët e paraqitur:

1.	Blertë Kaciu
2.	Medina Xhuraj Hoti
3.	Shqiprim Imeri
4.	Qëndresa Ramabaja
5.	Albin Ajvazi
6.	Diamanta Zogjani
7.	Arijana Lagjaj-Govori

Nr. prot. _____, Dt. _____

Një bashkëpunëtor të jashtëm për për mbajtjen e ushtrimeve për
lëndët: Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH) dhe
Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor),

Thirrja për angazhim:

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Besnik Morina

Prof. Asoc. Dr. Adhurim Rasimi

Prof. Asst. Dr. Jehona Ferizi Miftari



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Mosha (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë/ përkatësisht certifikata profesionale për kontabilitet dhe auditim				
1.	Blertë Kaciu	Dr.		/		8.56	8.67	PO	24/02/92 34 vjeçare	2	JO	
2.	Medina Xhuraj Hoti	PhD Can.		/		8.58	9.27	JO	15/07/97 29 vjeçare	/	JO	
3.	Shqiprim Imeri	PhD Can.		/		9.00	9.22	PO	01/08/93 35 vjeçar	7	JO	
4.	Qëndresa Ramabaja	Dr.		1		9.42	9.56	PO	22.08.98 28 vjeçare	3	JO	PO
5.	Albin Ajvazi	Msc. PhD. Kandi dat		/		8.71	9.39	PO	13/03/98 28 vjeçar	1	JO	
6.	Diamanta Zogjani	Ma		/		9.26	9.07	JO	27/07/99 27 vjeçare	/	JO	
7.	Artijana Llagjaj-Govori	Dr.		3		7.00	/	PO	27.08.80 46 vjeçare	21	JO	

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Bazuar në konkursin e shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me nr. prot. 1/746, të datës 29.05.2026, për angazhimin e personelit akademik dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, si dhe bazuar në Vendimin për formimin e Komisionit Vlerësues, Komisioni paraqet këtë raport përmbledhës për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën 5, për lëndët: **Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH) dhe Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor)**.

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, Komisioni është mbështetur në Rregulloren nr. 2/254, të datës 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, si dhe në kushtet e përcaktuara në thirrjen publike.

1. KOMENT VLERËSUES PËR KANDIDATEN BLERTË KACIU

Kandidatja Blerthë Kaciu, e lindur më 24.02.1992 në Lupç të Poshtëm, Podujevë, ka aplikuar për pozitën 5, për angazhim si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët: Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA – EFH) dhe Metodika e edukimit fizik (BA – Fillor), sipas konkursit me nr. prot. 1/746, të datës 29.05.2026.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në Shkencat Sportive në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 8.56. Po ashtu, kandidatja ka përfunduar studimet Master në Edukim Fizik dhe Sport në të njëjtin fakultet, me notë mesatare 8.67. Kandidatja gjithashtu ka dorëzuar diplomën e doktoratës në fushën e Kineziologjisë, të fituar në Universitetin “Ss. Cyril and Methodius”, Fakulteti për Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet në Shkup, si dhe dëshminë për nostrifikimin e diplomës përkatëse.

Sa i përket përvojës profesionale, nga CV-ja dhe dëshmitë e dorëzuara shihet se kandidatja ka përvojë si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” gjatë periudhës 2023–2025, si dhe përvojë si mësimdhënëse e Edukatës Fizike në shkollën e mesme të ulët “Akademia Ora” gjatë periudhës 2019–2022. Gjithashtu, kandidatja ka përvojë si trajnere futbollit, ndihmës-trajnere në Kombëtarën e Kosovës U15 për vajza, si dhe përvojë si refere futbollit.

Në dosje janë dorëzuar edhe dëshmi për trajnime profesionale, prezantime në konferenca shkencore, publikime, certifikata dhe mirënjohje të ndryshme në fushën e edukimit fizik, sportit dhe futbollit. Kandidatja ka dorëzuar gjithashtu certifikatë të gjuhës angleze dhe dëshmi nga organet kompetente se nuk është nën hetime.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në kriteret e përcaktuara me rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime, kandidatja **Blerthë Kaciu** i plotëson kushtet formale dhe profesionale për t’u përzgjedhur si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA – EFH) dhe Metodika e edukimit fizik (BA – Fillor).

2. KOMENT VLERËSUES PËR KANDIDATIN MEDINA XHURAJ

Kandidatja Medina Xhuraj, e lindur më 15.07.1997 në Pejë, me vendbanim në Prishtinë, ka aplikuar për pozitën 5, për angazhim si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët: Edukim fizik për fëmijërinë e hershme dhe Metodika e edukimit fizik, sipas konkursit të publikuar nga Universiteti i Prishtinës.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezultoi se kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin e Edukimit, Programi Fillor, në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 8.58. Po ashtu, kandidatja ka përfunduar studimet Master në Udhëheqje në Arsimit / Menaxhment në Arsim, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 9.27.

Sipas CV-së, kandidatja është duke vijuar studimet e doktoratës në Shkencë Pedagogjike në Universitetin “Ss. Cyril and Methodius” në Shkup. Gjithashtu, nga CV-ja rezultoi se kandidatja ka përfunduar punë si mësimdhënëse në shkollën fillore “Gjergj Fishta” në Prishtinë, nga viti 2020 e në vazhdim, si dhe përfundoi si asistente/mësimdhënëse ndihmëse dhe përfundoi në aktivitetet edukative, trajnimë, konferenca dhe publikime në fushën e edukimit.

Në dosje janë dorëzuar: kërkesa për aplikim, CV-ja, certifikata e lindjes, diploma bachelor, diploma master, certifikatat e notave bachelor dhe master, dëshmi për nostrifikim/barasvlerë të diplomave, dëshmi për publikime dhe dokumente të tjera relevante.

Megjithatë, duke marrë parasysh se lëndët për të cilat është shpallur pozita janë Edukim fizik për fëmijërinë e hershme dhe Metodika e edukimit fizik, ndërsa kualifikimet kryesore të kandidatit janë në Programin Fillor, Udhëheqje/Menaxhment në Arsim dhe Shkencë Pedagogjike, dokumentacioni nuk dëshmon kualifikim të drejtpërdrejtë në fushën përkatëse të Edukimit Fizik dhe Sportit.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe kriteret e përcaktuara me rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime, kandidatja **Medina Xhuraj** nuk i plotëson kushtet profesionale/formale për t'u përzgjedhur si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme dhe Metodika e edukimit fizik, për shkak se kualifikimi i saj akademik nuk është në fushën përkatëse të edukimit fizik.

3. KOMENT VLERËSUES PËR KANDIDATIN SHQIPRIM IMERI

Kandidati Shqiprim Imeri, i lindur më 01.08.1993, me vendbanim në Prishtinë, ka aplikuar për pozitën akademike asistent / bashkëpunëtor i jashtëm për lëndët: Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH) dhe Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor), sipas konkursit të publikuar nga Universiteti i Prishtinës më 29.05.2026.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezultoi se kandidati ka përfunduar studimet Bachelor në Edukim Fizik, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës, me notë mesatare 9.00. Po ashtu, kandidati ka përfunduar studimet Master në Edukim Fizik, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës, me notë mesatare 9.22. Sipas CV-së, kandidati është duke ndjekur studimet e doktoratës në Edukim Fizik / Kineziologji në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, nga viti 2024 e në vazhdim.

Sa i përket përvojës profesionale, kandidati ka paraqitur përvojë si asistent i angazhuar në lëndën Gjimnastikë dhe mentor i temave në Fakultetin Universi gjatë periudhës 2018-2019, përvojë si profesor në Akademia ORA në Prishtinë gjatë periudhës 2018-2020, profesor në shkollën e mesme BGT gjatë periudhës 2021-2023, profesor i ushtrimeve gjimnastikore në Cambridge Kids gjatë periudhës 2022-2025, si dhe profesor në shkollën profesionale “Shjefën Gjeçovi” nga viti 2025 e në vazhdim.

Në dosje janë dorëzuar edhe dëshmi për publikim shkencor, pjesëmarrje në konferenca, certifikata trajnimi, mirënjohje për kontribut në fushën e sportit/gjimnastikës, si dhe certifikatë nga gjykata, sipas së cilës kandidati nuk është i dënuar me aktygjykim të formës së prete.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe kriteret e përcaktuara me rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime, kandidati **Shqiprim Imeri** i plotëson kushtet formale dhe profesionale për t'u përzgjedhur si asistent/bashkëpunëtor i jashtëm për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH) dhe Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor).

4. RAPORT I SHKURTËR VLERËSUES PËR KANDIDATEN QËNDRESA RAMABAJA

Kandidatja Qëndresa Ramabaja, e lindur më 22.08.1998 në Gjilan, e cila ka aplikuar për pozitën asistente / bashkëpunëtorë e jashtme në Fakultetin e Edukimit, për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH) dhe Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor).

Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në Edukim Fizik dhe Sport në Universitetin e Prishtinës, me notë mesatare 9.42. Po ashtu, ka përfunduar studimet Master në Edukim Fizik dhe Sport në Universitetin e Prishtinës, me notë mesatare 9.55, si dhe një program tjetër master në Kolegjin AAB, me notë mesatare 9.71. Kandidatja ka të përfunduar edhe doktoratën në fushën e Edukimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit/Kineziologjisë, për të cilën ka dorëzuar diplomën dhe vendimin e nostrifikimit.

Sa i përket përvojës profesionale, kandidatja ka dëshmi për angazhim si bashkëpunëtorë e jashtme/asistente e angazhuar në Universitetin e Prishtinës, përfshirë angazhimin në Fakultetin e Edukimit në lëndën Metodika e Edukimit Fizik gjatë viteve akademike 2024/2025 dhe 2025/2026.

Po ashtu, ka përvojë në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, përvojë në mësimdhënie në institucione arsimore parauniversitare, si dhe angazhime sportive si trajnere, gjyqtare dhe delegate futbollit.

Kandidatja ka dorëzuar listë të publikimeve shkencore. Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmohet se ka publikime si autore e parë apo autore korresponduese në revista të indeksuara në Web of Science ose Scopus. Po ashtu, në dokumentacion nuk është dorëzuar dëshmi për përvojë në projekte shkencore/hulumtuese.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në kriteret e përcaktuara me rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime, kandidatja **Qëndresa Ramabaja** i plotëson kushtet formale dhe profesionale për t'u përzgjedhur si asistente/bashkëpunëtorë e jashtme për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA – EFH) dhe Metodika e edukimit fizik (BA – Fillor).

5. RAPORT I SHKURTËR VLERËSUES PËR KANDIDATIN ALBIN AJVAZI

Kandidati Albin Ajvazi, i lindur më 13.03.1998 në Podujevë. Kandidati ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 8.71. Po ashtu, ka përfunduar studimet Master në Edukim Fizik dhe Sport, në të njëjtin fakultet, me notë mesatare 9.39. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kandidati është duke ndjekur studimet e doktoratës në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në programin Kineziologji, por nga dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmohet se doktorata është e përfunduar. Sa i përket përvojës profesionale, kandidati ka dorëzuar dëshmi për kontratë pune në shkollën “Faik Konica”, si dhe vërtetim për praktikë profesionale në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në Departamentin e Sportit, gjatë periudhës 21.03.2022–31.03.2023. Gjithashtu, kandidati ka dëshmi për pjesëmarrje në konferenca shkencore/profesionale në vitet 2023, 2024 dhe 2026, përfshirë prezantime në fushën e edukimit fizik, sportit dhe arsimit.

Kandidati ka dorëzuar edhe certifikata profesionale dhe sportive, përfshirë programin “Mentor dhe Talent” në FFK, kursin CORE për gjyqtarë, certifikata të gjuhës angleze në nivel B2.2 dhe C1, si dhe dëshmi për kontribut në komunitet, universitet dhe aktivitete sportive.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në kriteret e përcaktuara me rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime, kandidati **Albin Ajvazi** i plotëson kushtet formale dhe profesionale për t’u përzgjedhur si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA – EFH) dhe Metodika e edukimit fizik (BA – Fillor).

6. RAPORT I SHKURTËR VLERËSUES PËR KANDIDATEN DIAMANTA ZOGJANI

Kandidatja Diamanta Zogjani, e lindur më 27.07.1999 në Prishtinë, me vendbanim në Sllatinë të Madhe, Fushë Kosovë.

Sipas kërkesës për aplikim, kandidatja ka aplikuar për disa pozita në Fakultetin e Edukimit, përfshirë: Pozita 3 – Shkencat e natyrës në fëmijëri të hershme / Shkencat e natyrës me metodologji, Pozita 5 – Edukimi fizik për fëmijërinë e hershme / Metodika e edukimit fizik, si dhe Pozita 6 – Psikologji e edukimit dhe lëndë të ngjashme.

Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në Pedagogji të Përgjithshme në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 9.26. Po ashtu, ka përfunduar studimet Master në Pedagogji në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës, me notë mesatare 9.07.

Sa i përket përvojës profesionale, sipas CV-së kandidatja ka përvojë si asistente administrative, asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, edukatore, asistente e mësimdhënësit, zyrtare për Help Desk, regjistruese, zyrtare për shërbim ndaj klientit dhe zyrtare e skemave pensionale. Po ashtu, ka përvojë në aktivitete vullnetare dhe pjesëmarrje në konferenca/seminare që lidhen me edukimin, miqëgenien dhe të drejtat e fëmijëve.

Megjithatë, për pozitën Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH) dhe Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor), dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon kualifikim akademik në fushën përkatëse të Edukimit Fizik dhe Sportit. Kualifikimi i saj bachelor dhe master është në fushën e Pedagogjisë, jo në Edukim Fizik dhe Sport. Gjithashtu, në dokumentacion nuk dëshmoohen publikime shkencore si autore e parë apo korresponduese në revista të indeksuara në Web of Science ose Scopus, dhe nuk ka dëshmi për përvojë në projekte shkencore/hulumtuese.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe kriteret e përcaktuara me rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime, kandidata **Diamanta Zogjani** nuk i plotëson kushtet profesionale/formale për t'u përzgjedhur si asistente/bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët Edukim fizik për fëmijërinë e hershme dhe Metodika e edukimit fizik, për shkak se kualifikimi i saj akademik nuk është në fushën përkatëse të edukimit fizik.

7. RAPORT I SHKURTËR VLERËSUES PËR KANDIDATEN ARIJANA GOVORI

Kandidata Arijana Govori / Arijana Lagaj-Govori, e lindur më 27.08.1980 në Bar, e cila ka aplikuar për pozitën Asistente në Fakultetin e Edukimit, për lëndët Edukimi Fizik për Fëmijërinë e Hershme (BA EFH) dhe Metodika e Edukimit Fizik (BA Fillor).

Kandidata ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Kulturës Fizike, me titullin Profesor i Kulturës Fizike. Megjithatë, sipas diplomës së dorëzuar, nota mesatare e studimeve themelore është 7.00, që është nën kriterin minimal të kërkuar prej 8.00. Kandidata ka përfunduar edhe studimet Master i Shkencave Sportive në Universitetin e Prishtinës, mirëpo në dokumentacionin e dorëzuar mungon certifikata e notave të studimeve master, andaj nota mesatare e këtij niveli nuk dëshmohet.

Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kandidata ka përfunduar edhe doktoratën në fushën e Shkencave të Kulturës Fizike, në Universitetin e Malit të Zi, në vitin 2026. Po ashtu, kandidata ka përvojë të gjatë profesionale në arsim si mësimdhënëse e Edukatës/Kulturës Fizike, duke punuar nga viti 2005 në institucione arsimore, përfshirë edhe SHML "Prenk Jakovë" në Prishtinë.

Kandidata ka dorëzuar edhe dëshmi për publikime shkencore/profesionale dhe certifikata të ndryshme profesionale në fushën e arsimit, sportit dhe zhvillimit profesional.

Koment përfundimtar:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, kandidata **Arijana Govori** ka kualifikim akademik dhe përvojë profesionale në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit, duke përfshirë edhe doktoratë të përfunduar dhe përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie.

Megjithatë, kandidata nuk i plotëson kushtet formale për pozitën përkatëse, pasi nota mesatare e studimeve themelore është 7.00, pra nën kriterin minimal të kërkuar prej 8.00, ndërsa nota mesatare e studimeve master nuk dëshmohet, sepse mungon certifikata e notave për këtë nivel studimi. Për këtë arsye, kandidata nuk rekomandohet për përzgjedhje.

Rekomandim:

Bazuar në Rregulloren me nr. **2/254**, të datës **17.07.2024**, për procedurat e vlerësimit për angazhimin e bashkëpunitorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Komisioni i propozuar nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, propozon kandidatit/en: **Qëndresa Ramabaja** për angazhim si bashkëpunitor/e i/e jashtëm/e / asistent/e për lëndët përkatëse.

Kandidati/ja i/e propozuar i plotëson kushtet e kërkuara për angazhim si bashkëpunitor/e i/e jashtëm/e, bazuar në **Nenin 7, pika 3.1 dhe 3.2** të Rregullores, përkatësisht ka të përfunduar studimet përkatëse në fushën relevante dhe plotëson kriterin e notës mesatare të kërkuar në studimet **Bachelor dhe Master**.

Në këtë drejtim, Komisioni ka vlerësuar dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët, duke marrë parasysh notën mesatare në studimet Bachelor dhe Master, pjesëmarrjen në konferenca shkencore dhe profesionale, punimet shkencore/profesionale, kontributet akademike, profesionale dhe institucionale.

Prandaj, bazuar në plotësimin e kushteve formale sipas Rregullores, në kualifikimin akademik, përvojën në mësimdhënie, veprimtarinë shkencore/profesionale dhe vlerësimin e përgjithshëm të dokumentacionit, Komisioni rekomandon që kandidati/ja i/e lartcekur të përzgjidhet për angazhim si **bashkëpunitor/e i/e jashtëm/e / asistent/e** për lëndët përkatëse.

Komisioni vlerësues:

1. **Kryetar:** Prof. Asoc. Dr. Besnik Morina
2. **Anëtar:** Prof. Asoc. Dr. Adhurim Rasimi
3. **Anëtar:** Prof. Asst. Dr. Jehona Ferizi Miffari




